

VENDIM
Nr.70, datë 6.10.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.45, DATË 30.7.2007 “PËR MIRATIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHQIPËRISË DHE
ENTIT RREGULLATOR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË TURQISË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “gj” dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2010, pasi shqyrtoi ndryshimet e propozuara për Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet enteve rregullatore të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Turqisë,

VENDOSI:

1. Të bëjë ndryshimet e Memorandunit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Entit Rregullator të Tregut të Energjisë Elektrike të Turqisë. (Memorandumi me ndryshimet përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Ngarkohet kryetari i ERE-s të nënshkruajë për ERE-n këtë Memorandum Mirëkuptimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për ndjekjen e zbatimit të këtij Memorandumi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta